



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar"" (Nismë deputeti) (Komision përgjegjës)
3. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar"" (Nismë deputeti) (Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Arben Pëllumbi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Tatiana Nurçe Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Vullnet Sinaj dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Dritan Bici, Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Majlinda Bozgo – Përgjegjëse sektori pranë Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar shqyrtimin e 2 amendamenteve të propozuara nga zoti Erion Braçe:

1. "Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar"";

2. "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar"". Këto nisma janë prezantuar në këtë komision nga zoti Erion Braçe. Ndërkohë, dhe ka përfunduar shqyrtimi dhe miratimi i këtyre nismave në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Relator i të dyja projektligjeve është zoti Besnik Baraj.

Do të dëgjojmë një prezantim të shkurtër nga zoti Baraj. Kemi ftuar sot në komision zonjën Ermira Gjeçi, zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe zonjën Majlinda Bozgo, përgjegjëse sektori në Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, të cilat janë këtu për të bërë sqarime dhe për t'u përgjigjur pyetjeve. Pas pyetje-përgjigjeve dhe diskutimeve, do të kalojmë në votimin në parim, nën për nën dhe në tërësi të nismave, me synimin që sot ta mbyllim procesin e shqyrtimit që nismat të jenë gati për miratim në seancën plenare të javës së ardhshme.

Para se ta marrin fjalën përfaqësueset së ministrisë, ia jap fjalën relatorit.

Besnik Baraj - Ju falënderoj, kryetar!

Unë do të flas shkurt, meqenëse problematika e tokës në Shqipëri është shumë komplekse dhe ndoshta, është bërë në një farë mase pengesë për zhvillimin ekonomik të vendit. Sigurisht, mbas shumë vitesh ne vijmë me këto propozime, të cilat mendoj se pretendojnë të rregullojnë mjaft padrejtësi të bëra në këtë sektor. Personat që kanë fituar tokën në përdorim sipas dispozitave të ligjit, praktikisht nuk mund të pajisen me aktin e marrjes në pronësi. Shqetësimi im, ndërsa lexoja këtë nismë dhe do të doja që të komentet e përfaqësuesve të ministrisë, të fokusohen edhe në problemin nëse ka rrezik që me këto ndryshime ne të hapim ndonjë mundësi abuzimi dhe mundësi për lindjen e problemeve të tjera. Pra, sa jemi ne të aftë, sa i kemi në vendin e duhur mekanizmat për të parandaluar një pështjellim tjetër në këtë sektor

(veçanërisht në drejtim të abuzuesve), që përvoja ka treguar se nuk mungojnë? Unë do t'i ftoja përfaqësuesit e ministrisë të prezantojnë nismën.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord.

Fjalën e ka zëvendësministria, zonja Rusi!

Ermira Gjeçi – Mirëdita të gjithëve!

Fillimisht, dua t'ju them se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bie dakord me propozimin e zotit Braçe, lidhur me kategoritë, të cilat përfitojnë nga këto ndryshime ligjore. Bëhet fjalë për të gjithë ata fermerë, ish-anëtarë të kooperativave bujqësore, të cilët e posedojnë tokën sot dhe e përdorin për një periudhë të gjatë prej 20-vjeçare. Ata kanë qenë anëtarë të kooperativave bujqësore, por nuk u është transferuar më 1.8.1991 gjendja civile, që në atë kohë ka qenë kusht për dhënien e aktit të marrjes së tokës në pronësi, por u është transferuar më vonë.

Kategoria e dytë janë ish-anëtarët ose ish-banorët e ndërmarrjeve bujqësore. Është një kategori arsimtarësh ose mjekësh të ndërmarrjeve bujqësore, por edhe këta e plotësojnë kushtin, që janë banorë të fshatit dhe janë posedues të tokës bujqësore. Ne mendojmë se nuk ka mundësi për abuzime, sepse kjo do të kalojë në proces verifikimi. Është një proces, i cili implementohet nga bashkitë, nuk implementohet nga qeverisja qendrore. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë vitit të kaluar, si koordinatorë e procesit të plotësimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, por edhe të regjistrimit të tyre, e ka ndjekur nga afër procesin në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha bashkitë pa përjashtim. Rezultatet gjatë vitit 2018 kanë qenë shumë të mira. Ka pasur edhe një fushatë promovionale e organizuar për të informuar të gjithë fermerët, të cilët nuk kanë pasur mundësi ta plotësojnë dokumentacionin ose të depozitojnë kërkesën e tyre për pajisjen me aktin e marrjes së tokës në pronësi, të paraqiteshin pranë bashkive në mënyrë që ta realizonin këtë brenda vitit 2018.

Ne mendojmë se nuk do të ketë arsye për abuzim. Jemi në një proces verifikimi. Të gjithë fermerët që do të përfitojnë, duhet të plotësojnë kushtin që të jenë banorë të fshatit dhe të kenë në përdorim tokat bujqësore.

Përjashtohen nga pajisja me aktin e marrjes së tokës në pronësi, të gjitha tokat, të cilat i ka Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në projektet e saj për t'u dhënë me qira.

Gjithashtu, përjashtohen të gjitha tokat mbi të cilat ka projekte zhvillimore. Këto janë 2 kriteret përjashtuese. Të gjithë ata që përdorin toka, që i plotësojnë këto 2 kriteret, nuk do të përfitojnë. Pjesa tjetër, që janë banorë të fshatit dhe kanë në përdorim toka bujqësore, do të përfitojnë.

Niko Peleshi – Ka pyetje?

Robert Bitri – Kush është kriteri i përcaktimit të përdorimit të tokës?

Ermira Gjeçi – Po flasim për tokën bujqësore dhe kriter është përdorimi i saj vetëm për qëllime bujqësore.

Robert Bitri – Kush është kriteri i përcaktimit të përdorimit apo i mospërdorimit të tokës?

Ermira Gjeçi – Mbjelljet. Kur flasim për tokën bujqësore, flasim për tokën e shfrytëzuar.

Robert Bitri – Do të paguajnë taksë?

Ermira Gjeçi – Po, patjetër paguajnë. Është një proces verifikimi që kryhet nga pushteti vendor, nga bashkitë.

Niko Peleshi – Ti mbledhim të gjitha pyetjet dhe më pas të përgjigjet zonja zëvendësministre.

Pyetja e zotit Bitri është se cili do të quhet përdorues faktik, nëse këta janë të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme, apo jo. Këtë po e plotësoj unë për t'i qartësuar të gjithë.

Fjalën e kanë me radhë: zoti Baraj, zonja Gjermani, zoti Bici, zoti Marto, zoti Beqaj, zoti Suli dhe zoti Sinaj!

Besnik Baraj – A është bërë ndonjë vlerësim i përafërt, se sa subjekte do të përfitojnë nga kjo nismë? Cili do të jetë impakti socio-ekonomik mbas marrjes së këtyre akteve nga subjektet?

Eglantina Gjermani – Së pari, desha të falënderoj zëvendësministren!

Theksoj se këto 2 nisma janë prezantuar dhe janë shpjeguar në këtë komision para pak kohësh nga zoti Erion Braçe. Një pyetje lidhur me impaktin, e bëri zoti Baraj, por unë desha të di nga zonja zëvendësministre se sa kohë do të duhet që të realizohet në praktikë ky proces? Nga momenti që miratohet parimisht në parlament dhe do të hyjë në fuqi, sa kohë do të duhet që përfituesit të marrin realisht atë që përcakton ligji?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Vazhdojmë me pyetjet e zotit Bici!

Dritan Bici – Ndoshta nuk ka shumë lidhje me këtë, por është edhe një kategori tjetër tokash, sidomos në zonën e ulët, që konsiderohet hapur tokë e re ose është si ato ndërtimet pa leje. Dikush ka 5 dynym me certifikatë pronësie dhe ka hapur edhe 2-3 dynym nga pylli pranë dhe i ka bërë pemëtoje. Ndoshta ky rast nuk përfshihet këtu. A ka ndonjë plan për këtë kategori tokash?

Të them të drejtën, ato janë një sipërfaqe shumë e madhe dhe shtetit nuk i leverdis t'i kthejë këto toka përsëri në pyll siç kanë qenë. Nuk është kollaj, se ka mbi 20 vjet që është krijuar një pemëtoje, ose një ullishtë dhe nuk është si një ndërtesë që e shemb dhe e ndërton përsëri brenda vitit. Unë jam marrë me këtë punë dhe ka pasur ide që kanë pasur nevojë për një koordinim midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Mjedisit dhe pushtetit vendor.

Tani Ministria e Mjedisit ka dalë jashtë kësaj, sepse pyjet kanë shkuar te pushteti vendor. A ka ndonjë projekt nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, apo nevojitet ndonjë nismë tjetër nga Kuvendi?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Vazhdojmë me pyetjet e zotit Marto!

Andrea Marto - Ju falënderoj, zoti kryetar!

Pyetja e parë është: a ka ndonjë vlerësim të përafërt se sa përqind e tokës bujqësore e ka përfunduar procesin, pra fermerët e posedojnë me dokumente pronësinë?

Pyetja e dytë, u prek edhe nga zonja Gjermani. Ne kemi ligje, të cilat i shtyjme vazhdimisht në kohë, sepse nuk realizohen procedurat. Unë kam bindjen se përsëri afati deri më 31.12.2019, është i pamjaftueshëm. Po sikur ta lëmë të hapur procesin, a ka ndonjë problem? A mund ta lëmë pa afat, sepse ky është një proces ligjor? Pse duhet t'i vëmë një kufi kohor?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Suli!

Rakip Suli - Ju falënderoj, kryetar!

Meqenëse gjatë diskutimit thatë, se kjo nismë ka të bëjë me personat që e kanë poseduar këtë pronë dhe e kanë zhvilluar realisht këtë pronë gjatë këtyre viteve dhe tashmë me këtë

projektligj, duke marrë dokumentacionin, dihet që u hapen më shumë mundësi për ta zhvilluar më tutje, sepse mundësohet edhe përfitimi i këtyre fondeve.

Afërsisht, sa është sipërfaqja e tokës në përdorim nga këto familje që do të përfitojnë nesër me miratimin e këtij ligji? A ka ndonjë informacion të saktë? Nëse nuk e keni tani, mund të na e sillni edhe me *e-mail*.

Edhe unë jam i mendimit që mund të jeni shumë të kujdesshëm me afatin, sepse normalisht jemi detyruar disa herë t'i shtyjme afatet e projektligjeve, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm për të vënë afatet. Më mirë të zgjasim afatin sesa ta rikthejmë edhe një herë në parlament për zgjatjen e afatit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Beqaj!

Ilir Beqaj - Në fjalën e zëvendësministres u tha se kjo punë që po propozohet nuk vlen në ato raste, kur ministria ka projektet e veta në ato toka.

A disponohet publikisht ky informacion për projektet e ministrisë? Ku?

Niko Peleshi – Zoti Rraja!

Më pas, zoti Panariti.

Rahman Rraja – Përshëndetje!

Më shumë për sqarim, në rastet kur u dha toka bujqësore në vitin 1991 sipas gjendjes civile, personat kanë marrë aktin e marrjes së tokës në përdorim. Për arsye të ndryshme, pretenduesi që ishte afër, e ka pushtuar tokën nga viti 1991 e deri tani. Kush ka të drejtë të marrë certifikatën e pronësisë, ai që pretendon se e ka tokën e vet dhe e posedon nga viti 1991 e deri sot, apo ai që ia ka dhënë komisioni me aktin e marrjes së tokës në pronësi, por për disa arsye nuk e ka nxjerrë certifikatën e pronësisë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Panariti.

Edmond Panariti - Unë do të thosha paraprakisht, se kjo çështje shumë delikate, shumë e rëndësishme, që është burim i konflikteve të panumërta që nga viti 1990 nuk mund të jetë thjesht nismë e një deputeti apo e një grupi deputetësh. Kjo kërkon një trajtim shumë të kujdesshëm me përgjegjshmëri të madhe nga parlamenti shqiptar, nga pozita dhe nga opozita. Nuk mund të futen duart në një proces, i cili ka shumë mangësi dhe shumë paqartësi.

Për shembull, me çfarë të drejte ju kërkoni që kjo kategori të shkojë në procesin e regjistrimit? E thoni këtu në mënyrë eksplicite: ajo kategori që e përdor tokën për veprimtari bujqësore, por ka mungesa në plotësimin e dokumentacionit të pronësisë apo të përdorimit. Kush ju jep juve të drejtën të çoni në regjistrim një kategori, e cila pavarësisht se mund ta ketë përdorur atë tokë, nuk e ka dokumentacionin ligjor përkatës, të rregulluar sipas normave dhe kriterëve të përcaktuara nga ligji për të shkuar në regjistrim? Në rast se ne do ta ngremë këtë si standard atëherë, përgatituni (jua them unë, megjithëse edhe ju duhet ta dini), se gjysma e Shqipërisë së Veriut punon tokën e vet, të trashëguar si pronë dhe nuk e ka njohur ligjin nr. 7501. Po qe se do të ndiqet kjo logjikë me parashkrim fituesi, atyre u takon të parët, sepse ata kanë dokumentet e tyre të pronësisë, të vërtetuara që ne kërkojmë t'u imponojmë ligjin nr. 7501. Atëherë, ku qëndron ky dopio standard aq më shumë për këtë kategori, e cila nuk i ka faktikisht dokumentet ose i ka ato të mangëta? Bëni shumë kujdes, mos fusni duart në një proces, i cili mund të gjenerojë konflikte të panumërta sociale! Kini shumë kujdes dhe mos e çoni procesin në mënyrë të sforcuar, kur ai vuan nga parregullsia qoftë të dokumentacionit, qoftë të matjeve! Ju e dini që titujt e pronësisë të bëra nga ish-kryetarët e komunave janë bërë shpeshherë me matje jashtëzakonisht të gabuara, janë bërë matje me spango. Pra, atij që praktikisht i figuron toka në letër, nuk i figuron në terren, sepse ka një spostim të jashtëzakonshëm në dokumente, si akti i marrjes së tokës në pronësi apo në përdorim, me atë që është në terren. Prandaj, edhe ky proces duhet parë me shumë kujdes.

Unë jam i shqetësuar edhe për faktin që i gjithë ky proces ka kaluar tashmë në dorën e një agjencie dhe do të kërkohet që ky proces edhe në mënyrë të sforcuar (për të mos thënë të dhunshme), të shkojë në hipoteka, duke mbartur me vete parregullsia të rënda të dokumentacionit, matje jo të sakta, gjë që do të jetë burim konfliktesh të panumërta. Prandaj, do t'ju lutesha të kuptoni që këto nisma për këto probleme, nuk mund të jenë individuale apo të 2-3 deputetëve; nuk mund të jenë nisma populiste, sepse më duket se ka edhe nisma të karakterit populist në këtë mes, për të favorizuar një kategori të caktuar dhe për ta lënë pjesën më të madhe të përfituesve të titujve të pronësisë, jashtë vëmendjes.

Duhet ta lëmë të veprojë Komisionin e Tokës. Ka një komision teknik në Ministrinë e Bujqësisë që merret me çështjen e tokës, që e ka futur në një proces dhe ne duhet të ecim në atë rrugë.

Në rast se do të vazhdojmë të fusim duart në mënyrë të vazhdueshme në këtë proces, që, natyrisht ka probleme të rënda të karakterit teknik te matjet, ka probleme të konflikteve që duhen zgjidhur nga gjykatat, këto nuk mund të bëhen me një amendim, i cili bie ndesh me këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pikërisht kjo që thuhet: janë punonjës, e përdorin token për qëllime bujqësore, që për mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit, nuk kanë certifikatë pronësie. Me çfarë të drejte ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kështu e kuptoj.

Niko Peleshi – Zoti Beqaj dhe më pas, zonja Gjermani.

Ilir Beqaj – Zoti Panariti, unë kam përshtypjen se ju nuk e keni kuptuar këtë propozim, të paktën, ashtu siç është shkruar këtu. Kjo nismë lidhet me një grup të caktuar, që kanë qenë vetëm pjesë të NB-ve dhe kur po e diskutonim këtë problem në fund të nëntorit, ishin në pamundësi për të kryer veprimet deri më 31 dhjetor 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Konstatimet tuaja për të gjithë procesin në Shqipëri janë të sakta, por ajo që u përgatitët të thoni me sa duket është e qartë nga kamerat që ikën. Thatë diçka që nuk ka lidhje fare me këtë projektligj.

Edmond Panariti – Është e shkruar këtu.

Ilir Beqaj – Jo, nuk ka lidhje fare me këtë që thatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje as me Shkodrën, as me Veriun, por ka lidhje me njerëzit, që data në shtator 1991 i gjeti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, ky këtu është konkret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju dëgjova dhe nuk ju ndërhyra.

Ky këtu është konkret. Ajo që thatë, nuk ka lidhje fare me ligjin. Ju ose nuk e keni kuptuar, ose i thirrët kamerat për një flluskë, se kamerat ikën tani. Ju thatë një flluskë, që nuk ka lidhje me ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, shqiptar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, më dëgjo! Po nuk e prekëm ne si politikanë, kush do ta bëjë? Nuk mund t'i lëmë shqiptarët të vriten. Ne duhet ta zgjidhim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para çdo deputet është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bujrëm, diskuto, por lexoje dhe kuptoje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka shpjeguar në komision zoti Braçe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju keni qenë në bojkot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Le të vijë se nuk është punë përtese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se nuk kam mbaruar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi lexuar dhe e kemi diskutuar këtë gjë.

Ne e miratuam, por meqenëse futëm në dhjetor 2 ligjet kryesore për pronat, thamë që kjo...

Meqenëse ato 2 ligje nuk kanë hyrë në fuqi, këto nisma bëheshin të nevojshme për një grup të caktuar, që lidhen me muaj të caktuar të vitit 1991. Kjo është e gjithë historia. Në fund fare, sigurisht, secili nga ne shpreh me votën e tij dakordësinë apo mosdakordësinë, por këtu nuk ka përpjekje për të futur duart. Përkundrazi, ka përpjekje për t'i dhënë mundësi dhe për t'u shpjeguar atyre njerëzve që ky proces i gjeti në një situatë të paqartë në vitin 1991 se në atë kohë kishin ndryshuar vendbanim, por nuk kishin ndryshuar atë që quhej pasaportizim në atë kohë, se kështu e njohim më kollaj dhe praktikisht, nuk kishin kohë ta kryenin këtë veprim deri më 31.12.2018, sipas ligjit të vitit 2008.

Në qoftë se deputetë të tjerë, grupe të tjera parlamentare të pozitës dhe të opozitës kanë dëshirë të japin kontribut, bujrrëm, janë të ftuar. Po nuk e zgjidhëm ne, kush do ta zgjidhë, vetë njerëzit? Për këtë duhet politika. Kur nuk e zgjidhën ata vetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ta kishin në dorë, e kishin zgjidhur ata, nuk vinte fare kjo çështje këtu. Ka 28 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zonja Gjermani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, flisni me radhë!

Zoti Panariti, ju dëgjuan të gjithë me shumë respekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Në fakt thelbi kryesor i ndryshimit që propozohet nga deputeti Braçe është shtyrja e afatit dhe i gjithë projektligji që po diskutojmë sot, këtë ka si thelb. Të gjitha procedurat dhe gjithçka që realizohet me këtë janë në ligjin ekzistues dhe po realizohen prej vitesh. U krijohet mundësia fermerëve, duke e shtyrë afatin për ta realizuar këtë proces. Besoj se duhet vlerësuar nisma e kolegut Braçe për faktin se i gjithë shqetësimi i tij dhe kjo nismë e tij, bazohet në interesat e këtyre fermerëve. Propozimi është prezantuar në komisionin tonë nga vetë nismëtari në nëntor apo në dhjetor nuk e mbaj mend.

Ndërkohë, pa diskutim, ne jemi sot këtu për ta diskutuar, për ta pasuruar dhe për ta përmirësuar dhe për të siguruar që ky afat do të respektohet, apo për të propozuar edhe shtyrjen e tij. E rëndësishme është që të gjithë të kenë akses dhe mundësi për ta realizuar. Një nga argumentet në relacionin e këtij projektligji të iniciuar nga nismëtari Braçe, është që nuk është zbatuar ligji ekzistues, sepse fermerët nuk kanë pasur akses dhe ligji nuk ka pasur mundësi të zbatohet. Ne vetëm po shtyjme afatin e tij. Prandaj, besoj se nëse e diskutojmë sot dhe pas sugjerimeve të Komisionit të Ligjeve, ne vetëm mund ta pasurojmë, përmirësojmë, të krijojmë mundësinë të zbatohet ligji dhe të mund të përfitojnë nga ky ndryshim ligjor të gjithë fermerët.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Unë mbase do të bëj në formë diskutimi, por desha t'i tregoja parafolësit, që ka qenë edhe ministër i Bujqësisë, se ne jemi duke e trajtuar 2 amendime të 2 ligjeve: njëri prej të cilëve është ligji nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar””.

Zoti Panariti, ju keni qenë ministër i Bujqësisë në atë kohë dhe në këtë ligj pa bërë asnjë ndryshim, te neni 2 i këtij ligji, germa “iii” thotë: “E përdorin token për veprimtari bujqësore por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë”.

Pra, është pranuar kjo që kur ju keni qenë ministër dhe ju nuk mund të flisni sot, sepse zoti Braçe kësaj pike i është referuar. Ju thatë se ka populizëm, por në këtë rast kishte *show*. Prandaj, nuk e pranoj këtë.

Këto mungesa dokumentacioni të këtyre fatkeqëve në zonat rurale, në ish-kooperativat, në ish-NB-të nuk janë për fajin e tyre, por janë për faj të procesit që u ka krijuar këto probleme ndër vite. Ndaj, nisma e zotit Braçe dhe dëshira e madhe e maxhorancës për ta zgjidhur përfundimisht këtë problem kaq të madh, që ka Shqipëria, sepse kemi gjysmën e ekonomisë së vendit pa pronë private, pa dokumente të pronës private, pra është një ngërç i madh që u është krijuar atyre njerëzve për rreth 27-30 vjet, duke i lënë në atë gjendje, pa një dokument të pronësisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është dëshira...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, mos më ndërprit!

Edmond Panariti – ... vërtetimet e pronësisë të dhëna nga ish-kryetarët e komunave pa firmë dhe pa vula. Mos e çoni procesin duke e sforcuar, kur është i mangët dokumentacioni. Unë vetëm këtë po them. Unë jam plotësisht dakord që procesi të shkojë drejt një finaleje, por duhet të jetë i bazuar në një dokumentacion dhe të mos bëhet në mënyrë të sforcuar se po u bë kështu, pastaj do të krijojmë procese të pa mbarim gjyqësore për kontestimin e tyre.

Vullnet Sinaj – Ju respektova dhe ju lejova të më ndërhyjni gjatë fjalës sime me respektin e madh, si një nga përfaqësuesit e opozitës që të paktën merr pjesë në mbledhjet e komisionit, sepse karriget e tjera janë bosh dhe ata nuk duan t'ia dinë, se janë duke menduar për rrëmujën që do të bëjnë në datën 16.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sinqerisht, ju falënderoj që jeni i vetmi anëtar i opozitës që po merrni pjesë në këtë komision për herë të dytë dhe unë ju lashë të më ndërprisni fjalën, por nuk mund t'ju lë të bëni propagandën e opozitës dhe të mos thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, parregullsitë e dokumenteve kanë qenë qëkur ju keni qenë ministër i Bujqësisë dhe ato janë shkruar në këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, mos e kthe politikisht!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ta mbaroj fjalën deri në fund?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urdhëroni, për procedurë!

Robert Bitri - Tani ta bëjmë që secili kur të ndërhyjë, të ngrejë argumente mbi bazën e këtyre që ne po diskutojmë, të mos flasim në parim dhe të mos bëjmë politikë.

E dyta, nëse kemi dëshirë për të përmirësuar këto që po shqyrtojmë ose nëse këto duhen shtyrë pak më tej, hajdeni të diskutojmë! Secili prej nesh brenda fushës së vet të flasë, por mos të flasim në parim, por të flasim konkretisht për këto ligje që kemi.

Niko Peleshi – Jam shumë dakord me zoti Bitri.

Është kollaj të spekulosh me çështjen e pronave, që është një lëmsh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iu përgjigja zotit Bitri, që e kishte për procedurë.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë nuk ka pyetje të tjera, do të mbaroni ju diskutimin, por do të mbaroj përgjigjen për zotin Bitri.

Ju lutem!

Unë flas më pak nga të gjithë këtu. Unë dua thjesht ta përforcoj mesazhin e zotit Bitri që të mos bëjmë politikë, sidomos kur e njohim fare përciptas këtë proces, sepse siç e tha edhe

zoti Beqaj, ajo për të cilën po flet zoti Panariti, nuk ka të bëjë fare me thelbin e këtyre ndryshimeve. Nuk bëhet fjalë për disa ndryshime që i hapin rrugën regjistrimit të pronës pa dokumente. Po e theksoj këtë që të mos keqinformohen shqiptarët. Nuk është fare fjala për këtë.

Së pari, kjo ka lidhje me shtyrjen e afatit të dy projektligjeve.

Së dyti, rregullon një kategori, që për arsye të mospërkufizimit siç duhet në ligj i përjashton subjektet për t'i regjistruar tokat bujqësore. Ata janë përdorues faktikë, por nuk i regjistrojnë dot, sepse siç u tha, në gusht të vitit 1991 kanë qenë banorë në ato zona, por nuk e kishin përfunduar pasaportizimin në atë kohë.

Ju lutem qëndroni brenda ligjit! Ta diskutojmë në parim dhe më pas nen për nen. Kush ka vërejtje, le t'i bëjë.

Natyrisht, këto projektligje nuk marrin përsipër të zgjidhin të gjithë problematikën e pronave. Ligji që përshpejton proceset e regjistrimit të tokës bujqësore, është akoma në procedurë parlamentare për shqyrtim dhe më pas për miratim, që është ligji për përfundimin e proceseve transitore të regjistrimit të pronës. Ai e fut në një shpejtësi tjetër së bashku me ligjin për kadastrën, që bën reformën institucionale për të zgjidhur shumë ngërçe, ku ky proces është futur ndër vite.

Sot nuk po flasim për procesin në tërësi, por po flasim për dy nisma të zotit Braçe të nevojshme në kushtet, kur ligji për proceset transitore do të marrë me sa duket, më shumë kohë për diskutim dhe për një zgjidhje afatshkurtër (oportuniste në fakt, por legjitime dhe ligjore). Prandaj, po miratohen këto dy nisma.

Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Atëherë, ne kemi dy ligje që amendohen nga zoti Braçe. Do të ishte mirë që të ishte vetë ai sot këtu, sepse ai është nismëtari i këtyre amendimeve, pavarësisht se ka ardhur më 24 tetor dhe i ka prezantuar në komision këto amendime, ato u ndërprejnë për ligjin e ri që do të dilte.

Megjithatë, unë vura re që u pyet zëvendësministrja, por unë nuk besoj se kjo është përgjegjësjë direkte. Duhej të ishte vetë zoti Braçe.

Unë e kam lexuar me vëmendje ngaqë jam edhe përfaqësuesi i një zone rurale banorët e së cilës merren më shumë me bujqësi. I kam parë me shumë interes amendimet e zotit Braçe për të dyja ligjet. Do të thosha se për ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", që ka të bëjë me

kooperativat, do të thosha se jam dakord me amendimet e zotit Braçe, duke bërë edhe unë dy propozime.

Te neni 17, pika 1/1, shkronja “e”, thuhet se afati i plotësimit të AMTP-ve përfundon në datën 31 dhjetor 2018. Unë do të propozoja që kjo fjali, ky kufizim të hiqet fare, ose të paktën të shtyhet me një vit.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, më falni që ju ndërpres, por kur të hyjmë në diskutimin nën për nen, mund të bësh propozime, se tani jemi në diskutimin në parim. Kur të vijë radha e këtij neni, mund ta diskutojmë.

Vullnet Sinaj – Dakord.

Atëherë, po pres kur ta diskutojmë nën për nen.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka diskutime të tjera?

Urdhëroni, zoti Bici!

Dritan Bici – Unë do të thosha se zoti Braçe e ka ndërmarrë këtë nismë dhe unë si agronom, dua ta falënderoj, sepse jam marrë edhe para vitit 1990, edhe pas vitit 1990 me tokën dhe kam qenë një ndër anëtarët e komisioneve aty që kam punuar, për ndarjen e tokës.

Zoti Braçe e ka marrë këtë nismë, sepse e ka hasur problem më shumë nga të gjithë ne, te zona e tij, ku është deputet. Ndoshta në zonën ku është zoti Braçe janë rreth 1068 familje, që nuk janë pak për një deputet që ai t’i marrë në konsideratë, sepse është një problem i madh.

Ndoshta, Fieri ka më shumë se 1000. Kavaja, Durrësi dhe zona fushore ku kanë pasur feramat. Në qoftë se e ndërmerr një nismë të tillë një deputet, ai duhet falënderuar për këtë. Ashtu sikurse i bëra pyetje zonjës zëvendësministre, në lidhje me këto tokat e reja, të palegalizuara, gjë për të cilën mund ta ndërmarr edhe unë një nismë, nëse do t’ia arrij, sepse është proces i vështirë.

Unë do t’i thosha profesor Panariti, se nuk është iniciativë e dobët, por është iniciativë e mirë, e cila është diskutuar këtu, kështu që kjo është për të mirën e zgjidhjes së problemit. Problemi nuk është i paqartë, sepse nuk bazohet në idenë se s’ka dokumente, por bëhet fjalë për persona që kanë aktin e tokës në përdorim, e kanë një dokument. E kanë përdorur dhe e kanë aktin e tokës në përdorim. Besoj se këta janë 90 % e pjesës së shëndoshë të këtij ligji. Mbase 10 % mund të kenë probleme të tjera, siç thotë edhe zoti Panariti, sepse problemet me tokën nuk marrin fund me aprovimin e këtij ligji, por ndoshta dhe fillojnë, sepse ne e dimë shumë mirë se

ligji 7501 ka shumë e shumë probleme në ish-komuna apo në bashkitë që janë tani, si dhe shumë njerëz që nuk janë pajisur me certifikatën e pronësisë. Kjo për shkak të konflikteve, por njëkohësisht edhe për shkak të anës ekonomike, dhe po i drejtohem prapë profesor Panariti, që problemi nuk është aq i paqartë, sepse azhurnimi i tokës ka qenë detyrim ligjor për të gjitha familjet fshatare, që të pajisen me certifikatë pronësie nëpërmjet këtij azhurnimi. Është edhe një kusht, sepse edhe të marrësh ndihmën ekonomike duhet të kesh certifikatën e pronësisë.

Këto janë probleme që hasen, por nuk janë aq të shumta sa të mos mund t'i përballojmë dot. Ndërmarrja e kësaj nisme dhe angazhimi i Kuvendit nëpërmjet kësaj nisme do të thotë se po mendohet seriozisht për zgjidhjen e problemeve të tokës. Aq më tepër që nëpërmjet udhëzimeve të qeverisë, pushteti vendor ka ngritur drejtoritë e tokave në administratat e bashkive, të cilat merren përditë me problemet e tokave, me konfliktet që lindin me zbatimin e ligjit 7501.

Ndoshta këto institucione vendore duhen përkrahur më shumë me fonde dhe me organikë, e përveç agronomëve duhet të kenë edhe juristë, për të çuar në zbatimin e saktë të këtij ligji.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zonja Rusi, një përgjigje për pyetjet! Sa më shkurt, të lutem!

Ermira Gjeci – Unë do të doja t'ia nisja nga diskutimi dhe pyetjet e zotit Panariti, për të dhënë një pasqyrë të të gjithë procesit të reformës së tokës bujqësore. Me të drejtë propozimet, vendimmarrjet për trajtimin ose rishikimin e kriterëve për përfitimin e tokës bujqësore kërkojnë angazhimin e një grupi të madh pune dhe të institucioneve përkatëse, që janë të përfshira. Kjo gjë është realizuar.

Propozimi i zotit Braçe ka qenë pjesë e ligjit të ri të proceseve transitore. Për këtë ligj ka punuar një grup i gjerë pune, me përfaqësi nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, hipoteka, bashkitë dhe të gjitha institucionet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e dhënies, plotësimit të titujve, por edhe certifikimit të tyre.

Meqenëse në lidhje me ligjin e proceseve transitore, është kërkuar nga deputetët e maxhorancës më shumë kohë për t'u njohur e për të vajtur më në detaje, e meqenëse ky ligj ishte planifikuar të hynte në fuqi janarin e 2019-ës, duke shfuqizuar afatin e plotësimit të titujve të pronësisë, i cili ka qenë deri në dhjetor të vitit 2018, propozimi i zotit Braçe – dhe prandaj Ministria e Drejtësisë është shprehur dakord me këtë – përmban dy pika kryesore: e para e të cilave zgjatja e afatit, afat që është lënë deri në fund të 2019-ës, duke pretenduar që brenda 2019-

ës ligji i proceseve transitore do të miratohet në parlamentin shqiptar, do të hyjë në fuqi, dhe automatikisht do të trajtojë të gjitha rastet ende të papërfunduara.

Pjesa e dytë nxjerr një kategori të re në lidhje me dhënien, plotësimin e titujve për disa fermerë, por duke plotësuar dy kushte themelore: janë banorë të fshatit, pra nuk janë banorë në zonat urbane, janë banorë të zonave rurale, dhe e përdorin tokën bujqësore për qëllime bujqësore.

Këto janë dy kushtet ose dy rrisitë e propozimit të zotit Braçe.

Nuk e di nëse arrita t'i sqaroja të gjitha pikëpyetjet ose çështjet për diskutim që kishte zoti Panariti. Mendoj se me këtë shpjegim arrita t'i përmbyllja.

Atëherë po filloj me pyetjen e parë, lidhur me verifikimin e përdoruesve faktikë. Procesi i verifikimit do të bëhet nga bashkitë. Ato kanë funksionin e verifikuesit nëpërmjet njësive administrative dhe drejtorive të tyre të bujqësisë, dhe janë të gjithë ata që e shfrytëzojnë tokën bujqësore për qëllime bujqësore, e që paguajnë taksat e tokës bujqësore.

Lidhur me të dhënat, me këto dy ndryshime, në relacionin e zotit Braçe, që ka bërë propozimin, bëhet fjalë për 1060 fermerë-përfitues, unë dua të ndaj me ju faktin e sa fermerë ose sa akte të marrjes së tokës në përdorim janë ende të paplotësuara për fermerët: janë diku te 20 mijë, prej të cilëve, në total mund të pretendojnë 8 mijë deri në 9 mijë fermerë, që janë ende të papajisur me aktet e marrjes së tokës në përdorim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë njëzet e ca mijë akte të marrjes së tokës në përdorim, por një fermer nuk ka një, mund të ketë më shumë se një, ndaj mesatarja është një me dy, në gjithë Shqipërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njëzet mijë akte të marrjes së tokës në përdorim, që janë në proces.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po i kthej përgjigje kësaj, por pyetjes nëse ka të dhëna se cilët janë përfitues.

Jo, një pjesë do ta trajtojë ky, një pjesë e trajton ligji i proceseve transitore dhe përfundimi i të gjitha rasteve që kemi.

Me pak fjalë, 2018-a ka qenë afati i fundit për plotësimin e titujve të pronësisë. Ministria e Bujqësisë ka vajtur në çdo bashki, duke tërhequr problematikën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo. Ndarja e tokës ka përfunduar. Plotësimi i titujve nga ana e bashkive është një proces më vete, i cili nuk ka përfunduar ende.

Atëherë, unë po dal tek të dhënat e përgjithshme.

Po flasim për 20 mijë - 25 mijë akte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e kanë ende. Mund ta kenë në përdorim, por nuk e kanë aktin e marrjes së tokës në pronësi. Toka bujqësore është ndarë nga komisionet e ndarjes së tokës. Pastaj bashkitë kanë plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi. Këtu ka një problematikë. Disa, në mungesë të dokumentacionit, kanë plotësuar aktet e marrjes së tokës në përdorim për akte të marrjes në pronësi. Totalisht janë 400 mijë akte të marrjes së tokës në pronësi, dhënë fermerëve.

Nga këto, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë rreth 50 % e tyre. Pa u pajisur ende me aktet e marrjes së tokës në pronësi, kanë ngelur diku te 10 mijë fermerë. Shifrat janë me përafërsi, nuk janë të sakta.

Ky informacion vjen nga bashkitë dhe duhet të përforcojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të përmend faktin që është një procedurë 28-vjeçare dhe kuptohet që informacioni për 28 vjet nuk është ekzakt. Mund të jenë diku te 9 mijë familje fermere. Ky është informacioni lidhur me tokën bujqësore. Kjo do të thotë, dhe po dal te përgjigjja e pyetjes së zonjës Gjermani, se fermerët, të cilët nuk disponojnë dokumentin e pronësisë, nuk mund të përfitojnë nga transaksionet e shitjes, të dhënies me qira të tokës bujqësore; nuk mund të përfitojnë nga ndihma financiare që jep qeveria shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, por edhe nga ndihma që jep BE-ja nëpërmjet IPARD-it, pasi duhet të disponojnë dokument mbi tokën bujqësore.

Procesi i plotësimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi është një proces i gjatë, i llogaritur nga ana ne është një proces 3-mujor që nga momenti kur fermeri bën kërkesën deri në dorëzimin e titullit, pasi në procesin e verifikimit të gjitha institucionet, që janë të lidhura me këtë proces, japin opinionin e tyre pasi bëjnë verifikimet përkatëse. Kjo do të thotë se fermeri, që pajiset me aktin e marrjes së tokës në pronësi, nuk ka qenë i pajisur më parë ose diku tjetër me këtë akt. Toka që ai po merr, nuk është tokë që e ka Agjencia e Trajtimit dhe Kthimit të Pronave, e cila do të shërbejë për kompensimin e fermerëve.

Lidhur me pyetjen e zotit Bici për tokat e reja, kjo është një çështje që ne e kemi trajtuar; e trajton ligji i ri i proceseve transitore. Ne mendojmë se koha është e mjaftueshme, sepse ligji i ri i proceseve transitore, që pretendohet të hynte në fuqi në janar, është shtyrë, por brenda vitit 2019 do të përfundojë. Me ligjin e ri të proceseve transitore nuk do të zgjidhen

vetëm këto problematika, por do të zgjidhen edhe të gjitha problematikat e tjera të ndeshura, qoftë edhe ato të procesit të regjistrimit.

Ne nuk kemi informacion se sa është sipërfaqja e poseduar për përfituesit me këto dy ndryshime, pasi është propozim i zotit Braçe, por unë ju ktheva një përgjigje më lart, pra që bëhet fjalë për 25 mijë akte që ne presim të plotësohen totalisht.

Lidhur me tokën bujqësore që është në pronësi të Ministrisë Bujqësisë me objekt dhënien e saj me qira, ky është një informacion i publikuar në faqen e Ministrisë së Bujqësisë, është transparent, dhe tek ASIG-u...

Majlinda Bozgo – Ne e kemi të publikuar tabelën e tokave me qira.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tabela e tokave me qira ka qenë e publikuar në faqen e ministrisë. Gjithashtu, edhe në faqen e ASIG-ut e kemi të publikuar tabelën, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, në faqen e ASIG-ut mund t'i gjeni të pasqyruara në mënyrë hartografike të gjitha ngastrat, aq sa kemi mundur, sepse sistemi i regjistrimit nuk na e jep mundësinë 100%, për arsye se nuk është i gjithi dixhital. Ngastrat janë të pasqyruara qartësisht edhe me të dhënat teknike në mënyrë hartografike dhe tabelare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermira Gjeci – Linkun ne mund t'ju dërgojmë. Unë do ta shikoj këtë çështje dhe do të komunikoj me ju.

Akti i marrjes së tokës në pronësi prevalon. Është dhënë një dokument zyrtar përpara atij që pretendon ose ka pushtuar tokën bujqësore.

Besoj se iu përgjigjja të gjitha pyetjeve.

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka ndonjë diskutim tjetër?

Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Në qoftë se ka problem në Shqipëri që nuk është zgjidhur ashtu siç duhet, pa e ndarë majtas apo djathtas, është problemi i pronës. Të gjitha forcat politike, që kanë qenë pushtet në këta 28 vjet, kanë kontribuar në mosrealizimin e këtij procesi që duhej të ishte dominant në Shqipëri. Prona më e madhe në Shqipëri është toka bujqësore. Shyqyr që një deputet merr guximin, por edhe lodhet për të dhënë një zgjidhje, qoftë edhe të vogël! Unë gjykoj se kushdo mund të kontribuojë në këtë proces. Të gjithë në deputetët, 140 sa jemi, majtas e

djathtas, në pozitë apo në opozitë duhet të kontribuojmë që të zgjidhim ato probleme që na dalin brenda zonës ose ato probleme që gjykojmë se duhet të zgjidhen dhe ka mundësi të zgjidhen. Kuptohet që vonesa e këtij projektligji, e kësaj nisme të zotit Braçe, erdhi për shkak se donim ta përfshinim te dy ligjet e pronës, qoftë për përfundimin e proceseve të pronës, qoftë në ligjin e kadastrës. Njëri nga ligjet u shty dhe tjetri u kthye nga Presidenti, gjë që solli shtyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve. Është prioritet që në këtij procesi t'i japim zgjidhje për këto familje. Edhe nëse është një familje, në qoftë se ne kemi mundësi ta zgjidhim, le ta zgjidhim. Dy personazhe në këtë komision, të cilët kanë qenë edhe ministra të Bujqësisë i kanë pasur mundësitë të kontribuonin shumë më tepër dhe t'u jepnin një mundësi zgjidhjeje. Analiza që ju keni bërë (qeveria e majtë filloi që në vitin 2013) arrin në konkluzionin që këtij proces duhet t'i jepet zgjidhje dhe vetë dy ligjet, që u sollën në parlament, do t'u japin zgjidhje më së miri dhe përfundimisht të gjitha proceseve, edhe atyre që tha Panariti. Gjykoj se ky projektligj nuk pengon dhe nuk krijon asnjë mundësi që të krijohen abuzime të tjera, prandaj edhe ia bëra pyetjen zotit Panariti, pra ta ndryshojmë ose ta riformulojmë më mirë që të mos krijojmë kushte për abuzime. Unë gjykoj që kur të diskutojmë nën për nën zoti Panariti do të ketë mundësi të kontribuojë për përmirësimin e neneve, që t'i shkruajmë më qartë. Unë kam vetëm një merak: duhet të jemi shumë të saktë në kontrollin që duhet të bëjmë, sepse ka lëvizje demografike nga zonat rurale në ferma, në të cilat procesi i ndarjes së tokave filloi më vonë. Ata mund të përfitojnë tokë bujqësore dhe në ligj thuhet "pas kontrollit që do të bëjë", kështu që pushteti lokal e ka shumë të lehtë dhe i njeh më shumë, sepse kontrollon një sipërfaqe shumë më të vogël se sa komisioni i ndarjes së tokave në qeveri, siç thotë zoti Panariti. Prandaj mendoj se zoti Braçe dhe të gjithë të tjerët, që kanë mundësi të njihen me zonat bujqësore, të kontribuojnë që ligji, i cili do të votohet më vonë në parlamentin tonë, t'i mbyllë të gjitha mundësitë dhe të gjitha gjërat që janë lënë hapur në këta 28 vjet. Kështu që unë jam pro nismës së zotit Braçe.

Niko Peleshi – Zoti Sina, pastaj zoti Panariti.

Vullnet Sinaj – Edhe unë e vlerësoj nismën e zotit Braçe për ndryshimet dhe amendimet e dy ligjeve, sepse lidhet me zgjidhjen e problematikës që mund të kenë banorë të zonave, siç ishin ata të fermave bujqësore, por edhe të kooperativave për titujt e pronësive, për shembull problematika për arsye të gjendjes civile të ndryshuar, pra banorë të ardhur nga një zonë tjetër u ka shkuar me vonesë certifikata e pronësisë.

Kam disa rezerva për amendimet, të cilat dua t'i shpreh më vonë, sepse më duket sikur zoti Braçe kufizohet pak te zona e tij, prandaj dua t'i them ndryshimet më pas. Për shembull, te ligji nr. 171/2014 ka disa kufizime datash që do t'i propozoj më pas. Mendoj se duhet t'i shikojmë më gjerë. Pra, as amendimet e zotit Braçe nuk do ta zgjidhim dot përfundimisht problemin e ndarjes së tokave bujqësore, por vetëm ligji i ri, që është diskutuar dhe patjetër që do të kalojë, mund ta zgjidhë përfundimisht problemin e tokave bujqësore në Shqipëri. Kështu që dua të them që t'i shikojmë me vëmendje nenet që ka propozuar zoti Braçe, për t'i bërë ato më të përgjithshme për të prekur interesat e shumë banorëve, sepse shikoj që ka ndonjë kufizim që prek banorët e zonës sime. Për shembull, mund të jenë 350 familje në Bashkinë e Selenicës që kanë nevojë për një ndryshim tjetër dhe ato propozime do t'i bëj kur të diskutojmë nen për nen.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Panariti!

Edmond Panariti – Faleminderit, zoti kryetar!

Absolutisht nuk e vë në diskutim vullnetin e mirë të zotit Braçe, i cili përgjithësisht mundohet që t'i japë drejtim një problemi, që i takon zonës tjetër. Ju ishit në sinkron me atë që thatë pak më parë, duket sikur ka një tendencë për të rregulluar gjërat në rang lokal, pa marrë parasysh specifikat që mund të kenë zonat e tjera dhe këtu ishte edhe thelbi i diskutimit tim. Ky është një proces, që duhet trajtuar në mënyrë integrale. Pra, sepse NB-të bujqësore nuk kanë qenë vetëm në Fier dhe në Lushnjë, por kanë qenë edhe në Veri, edhe Juglindje. Duhet parë specifika e poseduesve të titujve dhe akteve të pronësisë në këto zona të tjera për të parë nëse kemi ndonjë përplasje me propozimet që bën zoti Braçe.

Së dyti, në qoftë se ne do ta trajtojmë këtë çështje në mënyrë të segmentuar, me projektligje të veçanta, të jeni i sigurt, siç na ka ndodhur edhe më parë, që do të kemi përplasje të forta ligjore. Ky duhet trajtuar në mënyrë integrale.

Zonja zëvendësministre tha një gjë shumë racionale. Është e vërtetë që duhet ta çojmë këtë proces drejt regjistrimit final. Por si do ta çojmë atë proces drejt regjistrimit final? Duke e parë në mënyrë specifike si ekziston ky problem në rajone të ndryshme. Unë ju thashë një gjë, që është realitet, në rast se gjysma e Shqipërisë është përjashtuar nga ndihma, me programet e subvencioneve me fonde shtetërore apo me fondet IPARD-it, është pikërisht, sepse nuk regjistron token bujqësore. Pse? Sepse ata nuk e njohin ligjin nr. 7501, ata i kanë ndarë tokat sipas kufijve të vjetër, kanë më tepër se 20 vjet që i përdorin dhe mundet edhe atyre t'u dalë e

drejta, me parashkrim të fituesit, që është në Kodin Civil, që të njihen si pronarë *de facto*. Në fakt, duhet të jetë në interesin kombëtar, sepse ato përfundimisht marrin aktet e regjistrimit të pronës dhe janë përfitues të subvencioneve, janë përfitues të kredisë nga sistemi bankar, pra zhvillohet ajo zonë. Por, duke e segmentuar këtë punë dhe pa marrë specifikën e përfituesve në rang kombëtar, ne do të krijojmë përplasje. Prandaj thashë se e vlerësoj këtë, çështje, ai është një deputet i zonës dhe është normale që të marrë një nismë në favor të atyre. Por Shqipëria çështjet e pronësisë nuk i ka vetëm të një rajoni, i ka në të gjithë territorin. Prandaj them të ulemi, ta rishikojmë, mbase integrojmë në kuadrin e një nisme ligjore më përfshirëse, më rregulluese, më balancuese dhe patjetër ta çojmë drejt finales që është regjistrimi përfundimtar i tokave bujqësore në mënyrë që të mbyllet ky kalvar dhe të mos kemi konflikte gjyqësore, që pjesa më e madhe, pra 70% e padive në gjyq janë për çështje pronash. Prandaj them se procesi është shumë delikat, duhet të matet mirë kur të futet dorë, në mënyrë që mos krijohet përplasje me një zonë tjetër, e cila mund të ketë probleme jo të ngjashme me zonën, sepse këtu nuk flitet vetëm për Fierin dhe për Lushnjën, sepse është një nismë që merret për rang kombëtar, por që ju e thatë pak më parë, duket sikur ka një tendencë për ta zgjidhur problemin në nivel lokal.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj – Zoti Panariti, ka një problem me atë që ju thoni, pasi ju nuk keni qenë këtu në komision, bashkë me opozitën e keni bojkotuar 6 muaj parlamentin dhe mbledhjet e komisionit dhe nuk e dini fare për ligjet që kemi diskutuar, pra jeni i painformuar. Ne këtu kemi diskutuar për kalime transitore në pronësi të tokës bujqësore dhe kemi diskutuar edhe ligjin e kadastrës, por ju nuk keni faji, sepse nuk keni marrë pjesë. Kështu që ne, si maxhorancë, e kemi menduar shumë mirë dhe ka 1 vit që është një grup pune i posaçëm, i cili është mbledhur dhe ka dhënë një zgjedhje perfekte për të korrigjuar atë që nuk është bërë në vitet e tjera, por ju nuk keni qenë dhe nuk keni si ta dini. Kështu që ne e kemi menduar këtë gjë që thoni ju.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Le ta marrim këtë që thotë zoti Panariti, si një shenjë që të paktën një pjesë e opozitës, në mos e gjitha, do ta mbështesë, pikërisht, këtë që thoni ju zoti Panariti, pra një nismë për të zgjidhur në mënyrë integrale procesin e pronës. Ky proces ka filluar, kemi një draftligj, që quhet ligji “Për përfundimin e proceseve transitore”, së bashku me ligjin e kadastrës që u miratua në parlament. Pra, këto dy ligje i japin mundësi zgjidhjes së shumë çështjeve të pronës jo në mënyrë gjeografike, por tërësore. Problemi i Veriut që, në fakt, nuk është vetëm në

Veri, por në zonat ku nuk ka funksionuar ligji nr. 7501, por toka është ndarë fshatçe, nuk është në Veri, por edhe në zona të caktuara të Shqipërisë, merr zgjidhje me atë ligj. Natyrisht, personalisht, do ta them edhe në parlament, nuk jam i mendimit që ne duhet bëjmë një ligj me frymë legalizimi të zaptimit të tokës bujqësore, por, nga ana tjetër, duhet që ne t'u japim edhe përdoruesve faktikë, siç është rasti i Veriut, një dokument ligjor për posedimin e tokës bujqësore, në mënyrë që të hapet rruga, siç thatë edhe ju, e përfitimit nga fonde të caktuara, qofshin ato kombëtare apo të IPARD-it, për ta futur tokën në transaksione, qiramarrje, qiradhënie, pra ta vendosin në efieciencë e të tjera. Është e vërtetë që kur ne të zgjidhim këtë çështje kaq madhore, do të marrë edhe vetë sektori i bujqësisë një energji. Për shembull, 50% e tokës bujqësore nuk është e regjistruar, pra 50% e AMTP-ve nuk janë të regjistruara. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se nuk jepet dot dhe merret me qira noteriale, por në qoftë se nuk e merr me qira noteriale, atëherë nuk mund të zhvillohet me kultura, të cilat janë më shumë se sa 1-vjeçare. Çfarë ndodh? Ndodh që një pjesë e mirë punohen, por punohen me kultura 1-vjeçare. Domethënë, efektiviteti është i ulët.

Sot që po flasim këto hapa të parë dhe shumë të rëndësishëm janë hedhur. Pra, të paktën kemi një draftligj mbi tavolinë, i cili po merr kohën e tij të miratimit dhe me shumë gjasa, brenda këtij viti po e po, do të miratohet dhe do të fillojë zbatimin. Ligji “Për kadastrën” i hap rrugën ndërtimit të agjencisë që do të jetë ombrellë për të gjitha çështjet e pronës dhe kështu futemi në një fazë të re. Për momentin këto nisma, siç e thashë janë të domosdoshme për tu miratuar, sepse dy ligjet: ligji “Për plotësimin me AMTP të tokës bujqësore” dhe ligji “Për verifikimin e titujve të pronësisë” kanë skaduar në fund të dhjetorit të vitit të kaluar dhe kemi një vakum. Në qoftë se ne nuk do t'i rikthejmë ato ligje, pra t'ju shtyjme afatin, dhe do të miratojmë edhe këto nisma, të cilat kanë edhe disa rregullime të tjera, jemi në një ngërç dhe nuk mund të ecim me procesin e filluar të plotësimit me AMTP. Ashtu siç e tha zëvendësministrja, mund të jenë rreth 20 mijë fermerë, që e kanë të drejtën, sipas ligjit nr. 7501, por arsye të ndryshme nuk janë plotësuar me AMTP, kanë qenë në emigracion, kanë pasur shkaqe të tjera, pra nuk kanë bërë të gjithë procedurën, nuk kanë plotësuar dokumentacionin dhe nuk kanë marrë AMTP-në. Riaktivizimi i ligjeve të skaduara në fund të vitit të kaluar e hap përsëri këtë proces, janë disa mijëra dosje të hapura, por që duhen përmbyllur dhe për këtë arsye këto nisma bëhen të domosdoshme. Ashtu siç e thashë, nuk krijojnë ngërç, nuk krijojnë vakum, por krijojnë një tranzicion drejt miratimit të atij ligji integral, për të cilin foli edhe zoti Panariti, dhe me të vërtetë është i domosdoshëm.

A ka diskutime të tjera, apo të kalojmë në votimin në parim? Nuk ka.

Së pari, votojmë projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar”.

Kush është dakord për miratimin në parim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin në parim të projektligjit “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë për tokën bujqësore”, të ndryshuar”. Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nën për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar”.

Sugjerimet dhe ndryshimet e bëra nga Komisioni i Ligjeve na kanë bërë të reflektojmë për këtë projektligj. Pra, ato çfarë ka miratuar si ndryshime Komisioni i Ligjeve, ne i kemi integruar në projektligj dhe unë propozoj që diskutimin ta bëjmë sipas variantit të integruar.

Kalojmë te neni 1, për të cilin ka një diskutim nga zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj –Neni 1, që propozon zoti Braçe për ndryshim, i referohet nenit 2, pika 2, “i” të ligjit nr. 171/2014, i cili ka për qëllim përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, përfituesve sipas ligjit nr. 8053, datë. 21.12.1995 për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, të ndryshuar, të cilët nuk kanë bërë kalimin e pronësisë sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Pra, kemi kalimin e pronës nga përdorimi në pronësi. Në pikën 2, shkronja “i” thuhet se personat, të cilët duan të përfitojnë aktin e pronësisë, duhet të plotësojnë këto dy kushte: duhet që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji të kenë qenë banorë të njësisë së qeverisjes vendore dhe që nga data 01.10.1992 të mos kenë ndryshuar vendbanimin e tyre, sipas regjistrimit të gjendjes civile.

Në propozimin e zotit Braçe thuhet që të shfuqizohet pjesa e dytë e pikës 2, shkronja “i”, domethënë, ata, të cilët nga data 01.10.1992 nuk e kanë ndryshuar vendbanimin e tyre sipas regjistrimit të gjendjes civile. Problemi është se në pikën e dytë që zoti Braçe propozon për ndryshim, zgjidhet problemi i banorëve, që nuk e kanë ndryshuar gjendjen civile nga data

01.10.1992, por problemi është për ata persona, sepse ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2015, të cilët kanë ndryshuar gjendjen civile pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për shembull, në Bashkinë e Selenicës janë 350 familje të regjistruara që kanë ndryshuar gjendjen civile pas vitit 2015, të cilat mund të penalizohen nga ky ligj. Këta janë banorë që kanë ikur nga Selenica, janë regjistruar në Vlorë, por që shtëpitë i kanë në Selenicë dhe i punojnë tokat atje. Prandaj unë propozoj që pika 2, shkronja “i” të hiqet fare.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, ju lutem referojuni variantit integral, sepse aty mund të gjeni ndryshimet e bëra!

Vullnet Sinaj – Dakord.

Niko Peleshi – Kush është dakord për nenin 1, pika 1, sipas variantit të integruar? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te pika 2 e nenit 1. Kush është dakord? Kundër?

Vullnet Sinaj – Unë nuk i kam parë azhurnimet e Komisionit të Ligjeve, por kam diçka për të shtuar. Këtu është vendosur një kufizim, ku thuhet se e përdorin tokën për veprimtari bujqësore dhe e disponojnë aktin e marrjes së tokës në përdorim të regjistruarit deri në datën 31.12.1993. Zoti Braçe te kjo pikë ka parasysh të gjithë ata banorë të një ferme bujqësore, të cilët kanë ardhur nga një fshat tjetër, por që nuk u ka ardhur gjendja civile në këtë fshat dhe aty parashikon banorët, të cilët janë regjistruar në gjendjen civile brenda datës 31.12.1993. Po me ata që kanë ardhur në vitin 1994 çfarë do të bëhet?

Niko Peleshi – Ku e lexove këtë?

Vullnet Sinaj – Unë po lexoj propozimet e zotit Braçe.

Niko Peleshi – Shiko variantin e integruar.

Vullnet Sinaj – Dakord.

Niko Peleshi – Kush është dakord me pikën 2 të nenit 1, sipas variantit integral? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e nenit 1 në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet sipas variantit integral projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar”.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë për tokën bujqësore", të ndryshuar”.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, për dispozitat kalimtare. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Kundër? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë për tokën bujqësore", të ndryshuar”.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA